



# KONTROLLI FILLESTAR I DËGJIMIT: FËMIJA JUAJ NUK E KA KALUAR TESTIN E DËGJIMIT... ÇFARË DUHET BËRË TANI?

*Foshnjës tuaj i është bërë një test fillestar për dëgjimin. Ky kontroll për dëgjimin ka dalluar se një ose të dy veshët kanë një problem me dëgjimin.*

*Kjo është frikësuese: natyrisht që nuk prisnit që foshnja juaj të mos e kalonte testin fillestar të dëgjimit. Ndaj ne duam t’ju japim disa informacione se çfarë duhet të prisni që të ndodhë.*

## SI BËHET TESTI I DËGJIMIT

Një test negativ i dëgjimit tregon një humbje të mundshme të dëgjimit.

Për të qenë të sigurt, bëhet një kontroll i dytë nëse testi i parë ka qenë negativ. Testi i kontrollit të dytë është një përsëritje e testit të parë të dëgjimit. Një në dy foshnja japin një rezultat normal të dëgjimit gjatë testit të kontrollit të dytë. Nuk është për t’u çuditur sepse një ulje e përkohshme e dëgjimit mund të shpjegojë një rezultat negativ për testin e parë (një i ftohtë, etj.).

Nëse ka një rezultat të dytë negativ, foshnja juaj do të referohet për një testim të mëtejshëm.

## REFERIMI PAS TESTIT TË DYTË TË KONTROLLIT

Pasi të konsultohet me ju, infermierja rajonale do të caktojë një takim për ju në një qendër referimi për diagnostikimin e problemeve të dëgjimit për fëmijën tuaj. Testimi i mëtejshëm do të bëhet sa më parë që të jetë e mundur, në parim brenda një periudhe prej 2 javësh. Ata do ta testojnë foshnjën tuaj për të parë nëse ka një problem me dëgjimin dhe nëse ka, deri në çfarë shkalle është problemi.

Si prind, do të keni shumë pyetje në këtë periudhë të tensionuar dhe me ankth. Bëni pyetjet që mendoni se janë të rëndësishme dhe merrni informacion. Infermierja në Kind and Gezin (Fëmija dhe Familja) do t’ju informojë se çfarë ofrohet dhe do t’ju ndihmojë të gjeni zgjidhje që funksionojnë më mirë për ju.

## Foshnja ime reagon ndaj tingujve; a është ende e nevojshme të bëhen testime të tjera?

Po është e nevojshme të bëhen testime të tjera. Foshnjat me humbje të dëgjimit mund të reagojnë ndaj tingujve dhe dridhjeve në regjistra apo nivele të ndryshme; një reagim ndaj një tingulli nuk do të thotë se nuk ka asnjë humbje të dëgjimit.

Nëse foshnja juaj ka humbje të dëgjimit, është e rëndësishme të zbulohet kjo sa më parë që të jetë e mundur.

## REFERIMI:

Qendra e referimit:

.....  
.....  
.....

Adresa:

.....  
.....  
.....

Vizita:

.....  
.....  
.....

Mund të gjeni informacion shtesë në broshurën “Testi i dëgjimit është bërë... çfarë duhet bërë tani? në [www.kindengezin.be](http://www.kindengezin.be) website under gezondheid en vaccineren/health and vaccinations - opvolging/follow-up - medisch preventief consult/preventative medical consultation - gehooronderzoek/ hearing test.

